

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË – DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE, Gjyqtarja Lirije Kafexholli me sek.juridike Belkize Gashi në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Jemin Selim Zeqiri nga Mushtishti, për shkak të veprës kundërvajtëse nga neni 16 paragrafi I.1 të Ligjit për deklarimin, prejadhjën dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të Zyrtarëve të lartë publik, e në bazë të nenit 73,195 dhe 199 të Ligjit mbi kundërvajtjet, me datë, 14.03.2013 merrë këtë:

AKTVENDIM

I PANDEHURI : Jemin Selim Zeqiri lindur me dt. 07.11.1960 nw fsh. Mushtisht Komuna e Suharekws, ku dhe tani jeton, i martuar, ka të kryer fakultetin e mjeksisë, stomatologw, gjerë me tani kinse jo i denuar.

ËSHTË PËRGJEGJES

Sepse si Zyrtar i lartë publik - Këshilltar Komunal - Suharekë nuk e ka deklaruar gjendjen e pasurisë së tij për vitin 2011 deri me 31.03.2012 në Agjencionin Kundër Korrupsionit në Prishtinë

Me këtë veprim i pandehuri ka kryer kundërvajtje nga neni 17 paragrafi I.3 të Ligjit për deklarimin, prejadhjën dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të Zyrtarëve të lartë publik e aplikimin e të njejtit:

GJOBITET

Me gjobë në të holla në shumë prej 400 (katëqindë) EURO të cilin ka për ta paguar brenda 15 ditësh, pas plotëfuqishmërisë së këtij Aktvendimi në favor të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me nr.gjirollg.1000-4300-7000-0518, pagesa bëhet nëpërmes të kësaj Gjykate.

Nese denimin e caktuar nuk e paguan në afatin e caktuar i njëjti do ti zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 20 ditësh duke iu llogaritur nga 15 EURO. qdo ditë burgimi.

Shpenzimet e procedurës kundërvajtëse shuma paushalle prej 10 EURO, i paguan i pandehuri në afat prej 15 ditësh, pasi që ky aktvendim të merrë formën e prerë në favor të Gjykates Themelore Prizren - Dega në Suharekë – Divizioni për Kundërvajtje.

Me nga një ekzemplar të këtij aktvendimi të njoftohen palet.

ARSYETIM

Me kërkesen e Agjencionit Kundër Korrupsionit në Prishtinë me nr. 01/2508/12 te dt. 13.07.2012 është ngritur procedura kundërvajtëse, kundër të pandehurit me motivacion se ka kryer kundërvajtjenga neni 17 par.1.3 të Ligjit për deklarimin ,prejadhjën dhe kontrollin e pasurisë dhe të zyrtareve të lartë publik dh e deklarimin ,prejadhjën dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar

Gjykata mori ne pyetje te pandehurin Jemin Zeqiri I cili ne mbrojtjen e vetë deklaroi si zyrtar I lartë publik kam qenë I njoftuar që ta bëjë deklarimin e pasurisë ne Agjencionin kundër korrupsionit në Prishtinë mirëpo nuk kam mundur me deklaruar pasurinë ne afatin e parapar ligjor për shkak te gjendjes shendetesore si pasojë e lendimeve që I kam marrur nga një sulm fizik ku kame qenë në spital regjional në Prizren nga dt. 03.03.2011 deri me 28.03.2011 e që sipasoj e që sipasoj e lendimeve te rënda jamë ne trajtim te perhershëm me terapi konzervative dhe sherim ne banja ne afat prej 3 vjet. Deklarimin per preardhjen kontollin e pasurisë e kame bërë me dt. 30.05.2012 ku gjykates ia prezentoi vertetimin te leshuar nga Agjencioni kunder korrupsionit me nr.03 -3500/12, gjykates ia prezentoi fleteshimin e spitalit te Prizrenit, raportet e mjekve specialist që do te thotë se nuk kame patur ndonje qellim per mos deklarim te pasurisë por vetem kame qenë I orientum rreth angazhimit te sherimit tim personal.

Gjykata pas vlersimit të të gjitha provave në shqyrtimin kryesor: deklarates se te pandehurit, dhe pas vlersimit të të gjitha shkresave të cilat gjenden ne lëndë, konstatoj se i pandehuri ka kryer kundërvajtje nga neni 17 paragrafi I.3 të Ligjit për deklarimin, prejadhjën dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të Zyrtarëve të lartë publik andaj Gjykata të pandehurin e shpalli përgjegjës mirëpo konform neni 9 të Ligjit mbi kundërvajtjet ia zbuti de imin dhe ia shqiptoi denimin në të holla në shumë prej 400 EURO.

Gjykata me rastin e shqiptimit të denimit pati parasysh të gjitha rrethanat rënduse dhe lehtësuse të cilat ndikojnë në marrjen e Aktvendimit dhe se mendon edhe me këtë denim do të arrihet qellimi i denimit dhe do të ndikoj pozitivisht tek i pandehuri që në të ardhmën të mos përsëris kundërvajtje të natyres së tillë. Si rrethanë lehtësuese gjykata mori parasysh se I pandehuri nuk ka pas për qellim qe mos ta bëjë deklarimin e pasurisë pasi qe shifet se I njejt me vones e ka deklaruar pasurinë, por per arsye tw gjendjes shendetsore nuk ka mundur ta deklaroi pasurinë, për herë te pare ka ra ndesh me ligjin, ndwrsa si rrethan renduse gjykata muar peshen e kundervajtjes sw kryer.

Me sa u cek me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË – DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE

Sek.juridike
Belkize Gashi

Gjyqtarja
Lirije Kafexholli

UDHEZIME JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi kanë të drejtë ankese i pandehuri dhe parashtrusi i kërkeses, Gjykatës së Apelit në Prishtinë – Divizionit për Kundërvajtje, në afat prej 8 ditësh, pas marrjes se këtij Aktvendimi nepermes kesaj Gjykate.

DPK/DMP

03-1289/13

01

28.04.2013